



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2023:058106  
Datë: 02.10.2024  
Numri i dokumentit: 06239597

**C.nr.757/2023**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i përgjithshëm, Divizioni civil**, me gjyqtarin Nazmi Neziri, në çështjen juridike-civile të paditësit B. M., nr. personal ..., nga P., të cilin e përfaqëson i autorizuari avokatura “K. & A.s” me avokatët e saj S. K. etj., nga P., U. C..., ..., me autorizim, kundër të paditurës Komuna e Podujevës, Drejtoria Komunale e Arsimit në Podujevë - DKA, baza e kontestit: për shkak të kompensimit të 70% të transportit rrugor, vlera e kontestit: e pa përcaktuar, jashtë seancës me datë 02.10.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**KONSIDEROHET** se është tërhequr padia e paditësit B. M., nga P., kundër të paditurës Komuna e Podujevës, Drejtoria Komunale e Arsimit në Podujevë - DKA, lidhur me çështjen për Kompensimin e 70% të transportit rrugor.

**A r s y e t i m**

Paditësi B. M., i autorizuari avokatura “K. & A.” me avokatët e saj S. K. etj., nga P., U. C-, ..., me aktvendimin e kësaj gjykate C.nr.757/2023 të dt.03.07.2024, është ftuar që ta bëjë rregullimin e padisë dhe atë: Të bëjë rregullimin e petitumit të padisë duke e përcaktuar qartë kërkesëpadinë me të cilën do të saktësojë shumën e kërkuar për secilën kërkesë, Të përcaktojë vlerën e kontestit, Të përcaktoj periudhën brenda të cilës kërkon kompensimin, Ti dorëzojë provat të cekura në padi për vërtetimin e fakteve, dhe Autorizimin e rregullt për përfaqësim.

Nga shkresat e lëndës shihet se të njëjtin aktvendim paditësi-i autorizuari i tij e ka pranuar më dt.11.07.2024, siç vërtetohet nga fletëkthesa në shkresat e lëndës.

Bazuar si më lartë pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata konstatoi se për objektin e kontestit nuk ekziston më interes juridik, pasi që paditësi në afatin e caktuar nga gjykata e deri më momentin e nxjerrjes së këtij aktvendimi, nuk e ka paraqitur padinë e përmirësuar-plotësuar në aspektin objektiv siç ka qenë i detyruar me aktvendimi e cituar, andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në kuptim të dispozitave të nenit 102.3 i cili ka përcaktuar se: “Do të konsiderohet se është tërhequr parashtrësia po që se nuk i kthehet gjykatës brenda fatit të

*caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar parashtrësia do të hidhet poshtë.”, lidhur me nenin 387.1 pika c) të LPK-së, e konsideroi të tërhequr padinë.*

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, Departamenti i përgjithshëm  
C.nr.757/2023 të datës 02.10.2024**

**Gjyqtari:**  
Nazmi Neziri

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesë në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj Gjykate.